



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2542, datë 13.03. 2015

Për

“Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, datë 06.11.2014”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 13.03..2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, datë 6.11.2014

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP;
5. VKD nr.2522, datë 06.11.2014 për “Miratimin Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme-Dokumenti Përfundimtar”;

6. VKD nr.2523, datë 06.11.2014 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese”;
7. VKD nr.2524, datë 06.11.2014 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Plus Communication Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Plus Communication dhe vendosjen e masave rregulluese”;
8. VKD nr.2525, datë 6.11.2014 Për "Përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communications Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albanian Mobile Communications dhe vendosjen e masave rregulluese"
9. VKD nr.2526, datë 6.11.2014 Për "Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Altelecom dhe vendosjen e masave rregulluese"

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Vodafone Albania sh.a me Ref. LRD/0238/OX, datë 27.11.2014 (Referenca e AKEP: *nr. 2560 Prot., datë 27.11.2014*) me anë të së cilës Vodafone Albania ka paraqitur ankim administrativ për revokim të pjesshëm të Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2522, 2523 dhe 2524 datë 6.11.2014;
2. Shkresa e Albanian Mobile Communications sh.a. me *nr.5746/1-Prot*, datë 08.12.2014 (Referenca e AKEP: *nr.2638 Prot., datë 10.12.2014*) me anë të së cilës AMC ka paraqitur ankim administrativ ndaj Vendimeve të AKEP Nr.2522 dhe Nr.2525, datë 6.11.2014;
3. Shkresa e Altelecom sh.a, me nr.11410 Prot., datë 11.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2648 Prot., datë 11.12.2014) me anë të së cilës Altelecom ka paraqitur ankim administrativ për modifikim të Vendimeve te AKEP nr. Nr.2522 dhe Nr.2524, datë 6.11.2014;
4. Shkresa e Plus Communication sh.a. me nr.1149 Prot, datë 11.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2651 Prot., datë 12.12.2014) me anë të së cilës Plus ka paraqitur ankim administrativ për modifikim të pjesshëm të Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr.2522 dhe nr.2524, datë 6.11.2014;
5. Shkresa e AKEP me Nr. 2723 Prot, datë 18.12.2014, drejtuar të katër operatorëve celularë për informacion shtesë mbi ankimet e tyre administrative;
6. Shkresa e Vodafone Albania sh.a me ref. LRD/0258/OX, datë 26.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2723/4,Prot., datë 30.12.2014);
7. Shkresa e Albanian Mobile Communications sh.a. me *nr.5746/3 Prot.*, datë 23.12.2014 (Referenca e AKEP: *nr.2726/2 Prot., datë 29.12.2014*);
8. Shkresa e Altelecom sh.a, me nr.11763/1 Prot., datë 26.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2723/3 Prot., datë 29.12.2014);

9. Shkresa e Plus Communication sh.a. me nr.1209 Prot, datë 26.12.2014 (Referenca e AKEP: nr.2723/1 Prot., datë 29.12.2014)
10. Shkresa e Vodafone Albania sh.a. dhe Albanian Mobile Communications sh.a. me referencë të Vodafone Ref CEO/051/MF, datë 22.12.2014 (Referenca e AKEP: Nr.2743 Prot., datë 22.12.2014), drejtuar institucioneve të Kryeministrit, Kuvendit dhe MIAP.
11. Shkresa e Plus Communication sh.a. me Nr.34 Prot., datë 16.01.2015;
12. Shkresa e Albtelcom sh.a. me Nr.142 Prot., datë 21.01.2015
13. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (Relacioni);

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin nr. 2522, datë 06.11.2014, ka miratuar dokumentin “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme-Dokumenti Përfundimtar”, dhe bazuar në këtë dokument janë marrë Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014, për përcaktimin me FNT të katër operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre dhe masat përkatëse rregulluese për statusin e FNT.
2. Të katër operatorët celularë kanë depozituar në AKEP ankime administrative, sipas shkresave të cituara më sipër, si dhe informacion shtesë bazuar në kërkesën e AKEP. Secili operator ka ankimuar Vendimin nr. 2522, datë 06.11.2014, si dhe një apo disa nga Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014. Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014 kanë si pjesë arsyetuese dokumentin e analizës së tregut celular të miratuar më VKD nr.2522, datë 6.11.2014. Bazuar në:
 - 2.1. varësinë e Vendimeve nr.2522-2526, datë 6.11.2014, nga njëri-tjetri: detyrimet për FNT për të katër operatorët janë përcaktuar në dokumentin e Analizës së tregut miratuar me Vendimin nr. 2522, datë 06.11.2014, dhe me Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014, për secilin operator më vehte;.
 - 2.2. faktin se secili operator ka ankimuar Vendimin nr. 2522, datë 06.11.2014, vendimin individual për shpalljen me FNT dhe masat rregulluese, dhe direkt ose indirekt dhe vendimet e tjera individuale për shpalljen me FNT dhe masat rregulluese për operatorët e tjerë;
 - 2.3. vendimet nr.2523-2526 janë vendime individuale për secilin operator celular për statusin me FNT dhe masat përkatëse rregulluese, dhe masat rregulluese për një sipërmarrës individual të rrjetit celular kanë ndikim edhe tek operatorët e tjerë celularë, pra secili operator celular është palë e interesuar për vendimet e operatorëve të tjerë celularë;
 - 2.4. parimin e efikasitetit administrative në shqyrtimin e ankimeve për aktet administrative të nxjerra nga administrata publike;

vlerësohet e arsyeshme që shqyrtimi i ankimeve administrative për Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr.2522-2526, datë 6.11.2014, të jetë i përbashkët për të gjykuar mbi ndryshimet e mundshme të vendimeve të cituara

si dhe me vendime të vecanta të jepet përgjigje për secilin nga katër ankimet e operatorëve celularë. Kërkesat dhe argumentat kryesore të sipërmarrësve në këto ankime janë përmbledhur në pikat e mëposhtme 3-6, ndërkohë që në pikat e tjera trajtohen dhe çështje të tjera të lidhura me ankimet/vendimet e ankimuarra të ngritura nga operatorët gjatë kësaj periudhe.

3. Vodafone Albania sh.a. në ankimin e depozituar ka kërkuar revokimin e pjesshëm të Vendimeve nr. 2522, 2523 dhe 2524 datë 6.11.2014, që kanë lidhje me miratimin e dokumentit të analizës së tregut celular dhe vendimet individuale për Fuqinë e Ndjeshme në Treg dhe masat rregulluese për Vodafone Albania sh.a. dhe Plus Communication sh.a. Vodafone shprehet se Analiza e tregut (miratuar me Vendimin nr. 2522, datë 06.11.2014), e për rrjedhojë edhe vendimet nr. 2523 dhe nr. 2524, vjen në kundërshtim me kuadrin rregullator ekzistues, nuk justifikohet nga kushtet aktuale të tregut, dhe është e papërshtatshme e joproporcionale, e për rrjedhojë nuk është në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9918, i ndryshuar. Pretendimet kryesore të Vodafone janë:

3.1. Në vendimarrjen e KD të AKEP janë shkelur parime të rëndësishme administrative:

- a. Vodafone shprehet se, me këto vendime është shkelur parimi i proporcionalitetit (*neni 34/5, i ligjit nr. 9918*) në vendimarrje. Vendimarrja e organeve shtetërore duhet të mbajë parasysh përpjestimin e drejtë midis ndërhyrjes dhe gjendjen që e dikton atë. Ulja e menjëhershme e të ardhurave nga terminimi dhe ndërhyrja në pakicë nga AKEP me një afat njoftues minimal paraprak 1 muaj, nuk u ka dhënë kohë fizike operatorëve të përshtasin sistemet teknologjike, forcën e punës, rishikimin e planeve tarifore etj., nuk garanton përputhshmërinë ligjore me këtë afat. Ulja e tarifave të terminimit mbi 67%, brenda 8 muajsh sipas VKD nr. 2522 dhe 2523, është joproporcionale dhe jo e përshtatshme për të arritur qëllimet e synuara, kjo dëmton stabilitetin financiar të Vodafone dhe operatorëve të tjerë në treg, duke ndikuar në investimet e planifikuara, dhe në uljen e të ardhura në buxhetin e shtetit etj. Sipas Vodafone, AKEP nuk ka balancuar në mënyrë proporcionale dhe të përshtatshme përfitimin e synuar afatshkurtër të konsumatorëve, përkundrajt nxitjes së investimeve dhe qëndrueshmërisë së industrisë së komunikimeve elektronike. Kjo ulje, shprehet Vodafone mund të sjellë pasoja kompensuese në treg, që mund të rezultojnë në rritje të tarifave fundore për pajtimtarët.
- b. Vodafone shprehet se, masat rregullatore kanë cënuar parimin e sigurisë juridike, besueshmërinë, parashikueshmërinë në masat rregullatore. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Vendimet e AKEP përkatësisht me nr. 2431, datë 13.3.2014, nr. 2432, datë 13.3.2014, mbi miratimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, e konkretisht të rrjetit Vodafone, nga 2.04 lekë/min e parashikuar të hyjë në fuqi në janar 2015, në 1.48 lekë/min, e parashikuar të hyjë në fuqi në më pak se një muaj nga data e vendimit nr. 2522 dhe nr. 2523, në mënyrë flagrante cënon sigurinë juridike, besueshmërinë dhe parashikueshmëria në ndryshimet rregullatore. Këto ndryshime të shpeshta dhe brenda një kohe të shkurtër, kanë efekte të drejtpërdrejta në planet e biznesit, dhe të

paparishikueshme, dhe gjithashtu, nuk janë praktikë referuar organeve rregullatore të shteteve anëtare të BE.

- c. Masat rregullatore vijnë në kundërshtim me praktikat më të mira të BE. Vodafone shprehet se, referuar karakteristikave të “glide paths” , në rang ndërkombëtar referuar si kohëzgjatjes ashtu edhe mprehtësisë së tyre, asnjë nga këto parametra nuk gjen vend në “glide path-in” e propozuar nga AKEP, cka vjen në kundërshti me nenin 57/2 të ligjit 9918, mbi orientimin tek praktikat më të mira.

3.2. Tarifat e terminimit të Plus Communication sh.a. dhe asimetria, janë në kundërshti të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9918, kuadrin rregullator të BE, legjislacionin për mbrojtjen e investimeve, ndihmën shtetërore dhe mbrojtjen e konkurrencës:

- a. Asimetria e tarifave të miratuara me VKD 2522 dhe 2524, shprehet Vodafone, favorizon haptazi operatorin Plus, përkundrejt operatorëve të tjerë, në nivelin 340%. Kjo përbën shkelje të parimit të mosdiskriminimit referuar nenit 7, të ligjit 9918.
- b. Asimetria në nivelin 340% shkakton ineffiçensë të paprecedentë. Rekomandimi i KE i vitit 2009, dhe veçanërisht ERG, janë shprehur qartë kundër asimetrisë, pasi ajo favorizon operatorët ineffiçentë, duke bërë që pajtimtarët e njërit operator subvencionojnë pajtimtarët e operatorit tjetër. Gjithashtu, kjo i heq nxitjen operatorit asimetrik për inovacion, pasi ky operator do mbështetet tek MTR për të ruajtur fitimin, pa konkuruar me eficiency. Kjo asimetri e parashikuar për një kohë të gjatë do të përcillet tek tregu i pakicës, duke dëmtuar pajtimtarët.
- c. Asimetria, shpjegon Vodafone është në kundërshtim me Rec. 2009, datë 7.5.2009, ku parashikohet ndër të tjera, që asimetria për operatorët që nuk janë eficiency, nuk duhet të kalojë periudhën 4 vjeçare nga hyrja në treg.
- d. Shpallja e Plus, me FNT për tregun e terminimit dhe mundësimi i asimetrisë së lartë e të papërcaktuar, në kurriz të operatorëve të tjerë, me MTR bazuar në kosto, përbën subvencionim të pastër dhe shtrembëron konkurrencën, dhe bie ndesh me objektivat rregullator sipas nenit 7, të ligjit 9918.
- e. Neni 57, i ligjit 9918 përcakton se AKEP gjatë rregullimit të tarifave duhet të përcaktojë qartë periudhën kohore të rregullimit, dhe jo më të gjatë se 12 muaj. AKEP ka vendosur asimetrinë e Plus për një periudhë të papërcaktuar, deri në daljen e një vendimi tjetër, kjo sjell pasiguri juridike tek operatorët e tjerë.
- f. Gjithashtu, AKEP nuk ka zbatuar nenin 55/4 të ligjit 9918, mbi orientimin e tarifave në kosto, kjo nuk është zbatuar sa i takon tarifave të operatorit Plus.
- g. Vodafone shprehet se AKEP, vetë ka pranuar në Analizë fq. 75, se asimetria e Plus, është përtej çdo statistike në nivel European, e si e tillë bie ndesh me nenin 57/2,a, b, c, që parashikon vlerësimin e praktikës më të mirë të vendeve të BE. Nivelet më të larta të asimetrisë

në Europë janë shënuar nga Polonia, Norvegjia, Zvicra në 288% , në janar 2010 dhe Zvicra në janar 2011 në 239%. Aktualisht në të gjitha vendet e Europës, me përjashtim Turqinë dhe Zvicrën, niveli i asimetrisë është zero.

- h. Vodafone shpjegon se asimetria ka legjitimuar diferencimin e tarifave on-net e off-net, dhe ka shkaktuar ndërhyrjen në tregun e pakicës nga AKEP, në dëm të konkurrencës.
- i. Vodafone shprehet se, asimetria e sanksionuar me VKD nr. 2522 dhe nr. 2524, siguron subvencion të pandershëm të një kompanie shqiptare, në kurriz të investimeve të huaja si Vodafone Group dhe Deutsche Telekom apo Calik Goup. Duke shkelur haptazi interesat e investitorëve të huaj dhe duke penguar operatorët ndërkombëtarë të konkurrojnë në mënyrë të ndershme në treg. Kjo asimetri, që ka tiparet e ndihmës shtetërore, del haptazi me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005 “për ndihmën shtetërore”. Gjithashtu, shkel parashikimet nenit 2 të ligjit nr. 7764, “Për investimet e huaja” dhe nenin 71 të MSA e nënshkruar ndërmjet Shqipërisë dhe BE, lidhur me subvencionet shtetërore që shtrembërojnë konkurrencën. Po ashtu, ky vendim është në shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

3.3. Ndërhyrjet rregullatore bien ndesh edhe me parashikimet e ligjit nr. 9918:

- a. Vodafone shpjegon se, AKEP me masat e vendosura me VKD 2522 dhe VKD 2523, ka vepruar në kundërshtim me parimet bazë të rregullimit të tregut, të cilat justifikojnë ndërhyrjen në tarifën e shërbimeve me pakicë, vetëm nëse nuk ka konkurrencë efektive.
- b. AKEP me VKD 2523, ka vendosur që (1) tarifën e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare nuk duhet të jenë më të larta se tarifën e thirrjeve brenda rrjetit Vodafone; (2) sasia e minutave brenda rrjetit Vodafone të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jenë më e madhe sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, çka përfaqëson imponimin rregullator me masë detyruese për të përcaktuar ecurinë e tarifave off-net nëpërmjet këtyre akteve administrative.
- c. Edhe pse AKEP argumenton se kjo ndërhyrje është në nivel shumice si rrjedhojë e detyrimit të mosdiskriminimit, Vodafone shprehet se neni 56/1 i ligjit 9918, qartëson se çdo ndërhyrje rregullatore në nivel shumice i jep AKEP-it të drejtë të vendosë detyrimin vetëm për tregun përkatës.
- d. Vodafone po ashtu, shpjegon në lidhje me këtë nen (56) paragrafi i dytë, parashikon ndërhyrjet në tregun e pakicës (rregullimi i tarifës) kryhet vetëm nëse është arritur në përfundimin se në këtë treg nuk ka konkurrencë efektive dhe masat e marra në nivel shumice, kanë qenë të pamjaftueshme. AKEP mund të vendosë masa detyruese për moskufizimin e konkurrencës nëpërmjet zbatimit të tarifave të larta/ulëta të paarsyeshme, apo ofrimit të paketave të paarsyeshme, vetëm në rast të rregullimit të tregut të pakicës

- e. Vodafone shprehet se, AKEP në ndërmarrjen e masave të tilla rregullatore, duhet të veprojë bazuar në ligjin 9918 dhe aktet rregullatore (Rregullore për Analizën e Tregut), të marrë parasysh Rekomandimet e KE, BEREC, Rek. 2007 i KE, të cilat nuk e kanë përfshirë tregun e pakicës së telefonisë celulare si objekt rregullimi.
- f. AKEP ka vendosur të ndërhyjë për rregullimin e tarifës për një shërbim specifik, të tregut të pakicës, (thirrjet off-net), terminimi i thirrjeve drejt pajtimtarëve të një rrjeti tjetër kombëtar, cka është në kundërshtim me nenin 32, të ligjit 9918 dhe Rekomandimet e KE dhe përbën ndërhyrje të pajustificuar, për faktin se këto thirrje përbëjnë rreth 15% të volumit të të gjithë thirrjeve të gjeneruara nga operatorët.
- g. Vodafone shprehet se ndërhyrja e AKEP anashkalon disa elementë të rëndësishëm ekonomikë të karakteristikave të tregut, kur analizon rregullimin e tarifave të pakicës me qëllim balancimin e trafikut. Sipas analizës së Vodafone njehësimi i tarifave on-net/off-net, për të gjithë operatorët, rezultoi në të paktën 3 fishim të çmimit për konsumatorët shqiptarë, dhe ulje drastike të përdorimit të shërbimeve dhe pamundësi për t'u ofruar atyre volume të mëdha komunikimi përkundrejt çmimeve të ulëta të mëparshme.
- h. Ndërhyrja e AKEP, është e pajustificuar dhe joproportionale, shpjegon Vodafone, pasi nuk është marrë në konsideratë koha që u nevojitet operatorëve për të zbatuar rregullimet në tregun e pakicës. Afati prej 1 muaji i gjykuar nga AKEP si i mjaftueshëm, është joproportional dhe nuk jep kohë fizikë për marrjen e masave nga operatorët.

3.4. Detyrimi për ndarjen e llogarive është i pajustificuar dhe i papërshtatshëm në kuptim të ligjit 9918, në kushtet kur tarifat janë të orientuara në kosto:

- a. Vodafone shpjegon se, duke iu referuar Analizës, AKEP vetë shprehet se, në një treg si ai i terminimit në rrjetet celulare, ku tarifat orientohen në koston e operatorit eficient, stimujt për subvencion të ndërthortë apo diferencim në retail on-net/off-net, eliminohen. Vodafone thekson se, kur tarifat e terminimit janë të orientuara në kosto sipas modelit LRIC të pastër, aplikimi i ndarjes së llogarive, është një masë tërësisht e panevojshme, e pajustificuar, joproportionale dhe e papërshtatshme sipas nenit 34/5 të ligjit 9918. Zbatimi i kësaj mase rregullatore nuk justifikon qëllimin e saj dhe koston e lartë për çdo operator, referuar llogaritjeve të Vodafone.
- b. Aplikimi i ndarjes së llogarive, në kushtet kur operatorët kanë një tarifë dysHEME të përcaktuar terminimi dhe tarifa të rregulluara në nivel pakicë, e bën të pamundur konkurrencën në tregun e pakicës dhe minimizon lirinë tregtare të operatorëve, duke mos i lejuar të shfrytëzojnë eficientat e rrjetit për t'u dhënë tarifa të ulëta dhe shërbime të larmishme pajtimtarëve.
- c. Në kushtet kur Plus, në zbatim të vendimarrjeve të AKEP, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit 9918, është shmangur në mënyrë arbitrare dhe diskriminative, nga ndarja e llogarive, dhe

subvencionohet nëpërmjet asimetrisë, diskriminimi bëhet edhe më evident, shprehet Vodafone.

3.5. Në përfundim, të gjithë pretendimeve të parashtruara, Vodafone Albania sh.a., kërkon nga AKEP:

- a. Pranimin e ankimit administrativ;
 - b. Revokimin pjesërisht të VKD nr. 2522, datë 6.11.2014, për “Miratimin e dokumentit Analizë e tregut të telefonisë së lëvizëshme” për pjesën që ka përcaktuar detyrimin për tarifën e reja të terminimit, ndarjen e llogarive dhe ka vendosur eliminimin e diferencimit të thirrjeve brenda e jashtë rrjetit.
 - c. Revokimin e pikës 3.4, ii, iii dhe pikën 4, të VKD nr. 2523, datë 6.11.2014, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania sh.a. dhe vendosjen e masave rregulluese”;
 - d. Revokimin e pikës 3.4, ii, të VKD nr. 2524, datë 6.11.2014, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Plus Communication sh.a. me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania sh.a. dhe vendosjen e masave rregulluese”;
- 4.** Albanian Mobile Communications sh.a në ankimin e depozituar ka kërkuar revokimin e pjesëshëm të Vendimeve nr. 2522 dhe 2525 datë 6.11.2014, që kanë lidhje me miratimin e dokumentit të analizës së tregut celular dhe vendimin për Fuqinë e Ndjeshme në Treg dhe masat rregulluese për Albanian Mobile Communications sh.a . Sipas AMC, aktet e cituara më sipër në objektin e ankimit, vijnë në kundërshtim me kuadrin rregullator, në mënyrë të veçantë masat e propozuara për rregullimin e tregut, duke sjellë në vëmendje të AKEP edhe komentet e dërguara nga AMC mbi dokumentin e analizës së telefonisë së lëvizshme-këshillim publik, nëpërmjet shkresës nr.4004/1-Prot, datë 24.09.2014. AMC nëpërmjet ankimit administrativ të paraqitur kundërshton duke arsyetuar dhe paraqitur pretendimet e saj, si në vijim:

4.1. Koha e hyrjes në fuqi të akteve duhet rishikuar.

- Vendimi i AKEP për përcaktimin e AMC, sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në tregun e terminimit të thirrjeve kombëtare është marrë në 6.11.2014, publikuar në faqen zyrtare të AKEP më datë 13.11.2014, dhe AMC është njoftuar zyrtarisht me anë të letres zyrtare të AKEP, datë 13.11.2014 nr. Prot 642/20 hyrë në AMC datë 14.11.2014 nr. Prot 5746. Ndërkohë Vendimi i AKEP Nr.2525, datë 6.11.2014 Për "Përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communications Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albanian Mobile Communications dhe vendosjen e masave rregulluese, për tarifën e re nacionale të terminimit në rrjetin AMC, hyn në fuqi në 1 dhjetor 2014.
- Kjo situatë është e paprecedentë në marrëdhëniet e deri tanishme me AKEP, kur koha për hyrjen në fuqi të aktit nuk e tejkalon afatin ligjor të ankimit administrativ nga subjektet e interesuara. Duke gjykuar që një situatë e tillë

ndikon negativisht mbi të drejtat proceduriale, por edhe materiale të AMC kërkojmë pezullimin e hyrjes në fuqi të vendimit për tarifën e re të terminimit nacional të AMC nga data 1 dhjetor 2014 deri në datën e depozitimit nga ana jonë të këtij ankimi administrativ, i cili ka efekt pezullues në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative. Në të kundërt, do të ishim para rastit të shkeljes së të drejtave të AMC për një proces të rregullt ligjor.

- Ndërkohë po ky vendim përcakton që Sipërmarresi Albanian Mobile Communications Sh.a ndalohej të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmaresit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare. Sipas AMC, afati ankimor mbaron në datë 14.12.2014. Pas këtij afati janë 30 ditë të tjera për vendimarrjen e AKEP në lidhje me ankimin zyrtar të operatoreve. Sjellim në vëmendjen e AKEP mundesinë e një mbivendosje të afateve ligjore dhe hyrjes në fuqi të vendimit, ndaj edhe në këtë aspekt kërkojmë që të kihet parasysh të gjitha afatet e vendimarrjes dhe të harmonizohen atë me momentin e hyrjes në fuqi të rregullimeve të reja, cilido qofshin ato në perfundim të procesit të ankimit administrativ. Ky sugjerim, përveç aspektit formal juridik synon të evitohet lindjen e një problematike mjet të madhe komerciale, teknike dhe të ofrimit të shërbimit me cilësi dhe tarifa të sakta për abonentet.
- **Ndaj AMC propozon si datë të hyrjes në fuqi për Vendimet KD-se, të cituara më sipër, të jetë data 1 Korrik 2015.**

4.2. Shfuqizim të detyrimit për ndarjen e llogarive (account separation) për AMC/Vendosje të detyrimit edhe për PLUS.

- Nje pretendim tjetër i AMC i shprehur edhe në komentet e sjella me shkresën e sipërcituar (në fund të procesit të këshillimit publik), është për masën rregullatore të ndarjes së llogarive, duke e konsideruar jo vetëm si të panevojshme, jo-proporcionale, ndërsa në kushtet kur operatori Plus nuk i vendoset i njëjti detyrim për masën rregullatore të sipërcituar, është i dukshëm edhe aspekti diskriminues.
- Shoqeria AMC kërkon shfuqizimin e detyrimit për accounting separate cost, i cili ka të bëjë me kontrollin e vendosjes së tarifave të terminimit nëse janë abuzive. Ndërkohë këto tarifa sipas vendimit të AKEP rregullohen me anë të metodës benchmark pure LRIC dhe kanë arritur nivelin më të ulët të mundshëm. Kështu s'ka asnjë arsye që të implementohet obligimi për accounting separate cost, i cili në vetvete krijon një problematikë tjetër shtesë tek operatorët celulare duke kërkuar burime njerezore dhe monetare shtesë për realizimin e tij. Për më tepër implementimi i tij nuk do të jepte ndonjë rezultat përveç se më shumë mundësi të jenë më të larta tarifatat e terminimit të shoqërisë AMC të rregulluara nga AKEP bazuar në benchmark dhe jo në model kostoje. Pra në këtë rast kemi të bëjmë me mungesën e shkaqeve për vendosjen e një rregullimi të tillë.
- Një tjetër masë është dhe ndryshimi i masave rregullatore në lidhje me ndarjen e llogarive, duke hequr një masë të tillë për operatorin PLUS, pasi të gjithë operatorët janë me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet perkatëse,

- ndaj dhe masat përkatëse rregullatore duhet të jenë të njëjta për të gjithë, në bazë të nenit 34, pika 2 "Analiza e tregut" dhe 41 "Detyrimi për ndarjen e llogarive" të ligjit 9918, të ndryshuar. Heqja e detyrimit për ndarjen e llogarive për operatorin PLUS me justifikimin se ky operator ka pjesë të vogël në tregun me pakicë është një vendim i pabazuar dhe nuk qëndron, pasi në dy tre vitet e fundit të ardhurat e operatorit PLUS kanë qënë gjithnjë në rritje, dhe nga 2011 në 2013 janë rritur me 3% (Ref.: "Treguesit statistikore dhe financiare te tregut viti 2013', fq.13). Po ashtu, PLUS ka rritje të konsiderueshme dhe të bazës së pajtimtarëve gjatë këtyre viteve, sidomos të përdoruesve me kontratë nga 7% në vitin 2011 në 20% në fund të vitit 2013.
- Ky veprim është në kundërshtim të objektivit kryesor që ka AKEP si organ rregullator: "promovimi i konkurrencës në treg", pasi deformon rëndë tregun duke diskriminuar midis operatorëve në vendosjen e masave rregullatore dhe duke i vendosur kështu ata në pozita krejt të pabarabarta kur të gjithë ata karakterizohen nga të njëjtat karakteristika për të pasur FNT në tregun e terminimit të thirrjeve. Kjo është një shkelje e nenit 7/3 "Objektivat rregullatore" të Ligjit nr.9918.
 - Ndaj, AMC është kategorikisht kundër vendimit për heqjen e detyrimit rregullator për ndarjen e llogarive për operatorin PLUS, pasi një veprim i tillë shtrembëron në mënyrë të rëndë tregun si dhe diskriminon operatorët e tjerë në favor të qartë të këtij të fundit, në shkelje të hapur të parimeve rregullatore dhe objektivave mbi të cilat vepron një organ rregullator.

4.3. Tarifat e terminimit të thirrjeve nacionale në rrjetin e AMC dhe asimetria e tarifës së terminimit të PLUS

a. Kundërshtime të metodës benchmark për përcaktimin e tarifës së terminimit

- Sipas AMC, vendosja e metodologjise benchmark sipas tarifave mesatare të BE-së për të ndryshuar tarifën e terminimit në rrjetet celulare në përcaktimin e vlerës 1.48 lek/min, hyrë në fuqi më datë 1.12.2014, është i pajustificuar nga pikepamja rregullatore në dritën e kuadrit rregullator të vendit tone dhe atij të BE dhe i pabazuar në ligj e në aktet rregullatore të BE si një burim i së drejtës në këtë fushë, kur tashme tarifën e terminimit në këto rrjete janë të përlllogaritura në bazë të metodologjisë BULRAIC sipas glide path-it të analizës së tregut celular Korrik 2012, dhe me konkretisht: Vendimet e AKEP nga 2119 deri 2122, dt. 04.07.2012 (për deklarinimin me FNT respektivisht për AMC, Eagle Mobile, Plus Communication dhe Vodafone Albania).
- AMC referon se, në dokumentin perfundimtar të analizës së tregut, AKEP ka thelluar akoma me tej trajtimin diskriminues në dëm të AMC duke vendosur ndryshimin e tarifës së terminimit. Sipas AMC, neni 7 i Ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, përcakton së AKEP në ushtrimin e funksioneve të tij duhet të marrë parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Europian dhe BEREC. Në mënyrë të veçantë, në kuadër të përcaktimit të tregjeve dhe rregullimit të tyre AKEP duhet të ketë parasysh rekomandimet e BE.
- AMC referon se: sipas neneve 45, 49 dhe 57 del shumë qartë kërkesa për aplikimin e parimit të orientimit drejt kostos dhe preferencën e qartë për metodologji të saktë të kalkulimit të këtyre kostove krahasuar me metodat

krahasimore. Vlen gjithashtu të përmendet që në krye të herës se AKEP ka shpenzuar vlera të konsiderueshme të financave publike për mbulimin e kostos së konsulencës ndërkombetare për hartimin e BULRIAC. Kjo metodologji dhe zbatimi i saj ka kërkuar gjithashtu një shpenzim të konsiderueshëm financiar, por jo vetëm (burime njerezore, trajnime, kënaqësi, konsulence, IT, etj) edhe nga ana e operatoreve. Për këto arsye AMC shprehet kundër përcaktimit të tarifave të terminimit bazuar në metodologjinë krahasimore benchmark sipas mesatares së tarifave të terminimit të vendeve të BE-së .

- AMC referon se, AKEP nuk ka ndërmarrë asnjë hap apo inicuar asnjë proces për fillimin e implementimit të një modeli kosto për përcaktimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare, siç përcaktohet dhe në direktivat dhe rekomandimet e BE-se, duke cituar referencat përkatëse të Rekomandimit të BE-së të vitit 2009, në pikat 1 dhe 2 të tij.
- Aplikimi i tarifës së re të terminimit 1.48 lekë/min është një ulje drastike nga 4.57 lekë/min që ishte në fuqi deri në Mars 2014. Glide pathi i ri i aprovuar në Mars të 2014 vendosi një tarifë 2.66 lekë/min në fuqi deri në dhjetor të 2014, ndërsa për në Janar të 2015 parashikonte një tarifë prej 2.04 leke/min, ndërsa tarifa 1.48 leke/min ishte parashikuar në 1 Janar të 2016. Ky ndryshim ka sjellë një reduktim në nivele rreth 60% brenda me pak se një viti, dhe në këtë mënyrë nuk mundëson rekuperimin e kostove që manifestojnë operatorët gjatë aktivitetit të tyre.
- Tarifat e reja të terminimit të përcaktuara nga AKEP impaktojnë negativisht në fitimin e kompanive, reduktojnë investimet e kompanive, sidomos në teknologji dhe në një moment në të cilin AKEP po planifikon lancimin e teknologjisë 4G në treg dhe që kërkon investime të konsiderueshme, krijon pasiguri në planet e bizneseve që operatorët kanë hartuar nëpërmjet strategjive të tyre. Kompanite nuk janë në gjendje të ndërtojme buxhete të shëndetshme dhe të bëjnë planet strategjike afatgjata

b. Kundërshtime për tarifën e terminimit në rrjetin Plus dhe asimetrinë

- Vendosja e aplikimit të tarifës së terminimit për AMC në 1.48 lek/min, hyrje në fuqi me datë 1 Dhjetor 2014, ka rritur deri në ekstremitet asimetrinë me operatorin PLUS, vlera e të cilit mbetet e pandryshuar në 6.52 lek/min. Niveli i asimetrisë AMC/PLUS nga 145% që ishte më parë (sipas vendimeve të AKEP për rishikimin e tarifave të Mars 2014) shkon në rreth 340% me hyrjen në fuqi të tarifave të reja të terminimit.
- Nëpërmjet veprimeve të AKEP, PLUS Communications është operatori që po përfiton më shumë nga vendimet finale të AKEP për ndryshimin e tarifave të terminimit. Në këtë mënyrë për PLUS krijohet mundësia të subvencionojë tarifën me pakicë, apo të rrisë fitimet si dhe investimet në infrastrukturë dhe në frekuencë.
- Një praktikë e tillë nuk haset në asnjë nga vendet e BE-se apo të rajonit ku pothuajse në të gjitha vendet me përjashtim të Turqisë, Qipros dhe Luksemburgut, niveli i asimetrisë në tarifën e terminimit është zero. Edhe në tre vendet: Turqi, Qipro dhe Luksemburg niveli i asimetrisë midis operatoreve celulare në tarifën e terminimit është i ulët, si në tabelën e referuar në raportin e BEREC "BoR (14) 55 Termination Rates Benchmark Snapshot as of January 2014"

- Edhe ne raportin e "ERG (07) 83 final 080312 ERG's Common position on symmetry of fixed call termination rates and symmetry of mobile call termination rates"; e perdorur si reference dhe ne roundet e tjera te analizave te tregut, citohet ne faqen 86 te dokumentit: "In average/ MTRs of operators having between 3 and 5 years of entry delay are 17% higher than the lowest MTR in their country and MTRs of operators having between 6 and 11 years of entry delay are 35% higher than the lowest MTR in their country". Sipas ERG: Asimetria e pamerituar dhe e pajustificuar, perben shkak per rreziqe si:
 - o favorizim per operatore jo eficente, qe eshte ne diskriminim midis pajtimtareve te ketyre operatoreve;
 - o favorizimi i heq stimujt operatorit asimetrik per inovacion pasi ky i fundit zgjedh
 - o operatori perfitues te mbeshtetet te tarifa te terminimit me te larta per te ruajtur fitimin dhe asimetria e tejzgjatur krijon nje lloj sigurie e cila do jete e veshtire te hiqet ne te ardhmen duke minuar eficencen;
- Nje tjetër aspekt ne lidhje me nivelin e asimetrise midis tarifave te terminimit te operatoreve me ate te PLUS, lidhet me afatin kohor se deri kur parashikohet te vazhdoje kjo asimetri, e cila sipas glide-path-it te percaktuar ne vendimet perfundimare te AKEP date 06.11.2014 eshte lene e papercaktuar, duke krijuar mundesi te qarta per perfitime financiare nga ana e PLUS kundrejt operatoreve te tjere ne treg. Niveli i asimetrise mbetet i pacaktuar ne kohe deri ne nje vendim te ardhshem te AKEP sic evidentohet ne kete dokument final sipas Vendimit te AKEP Nr.2522, date 06.11.2014 duke dhe nje sinjal negativ tregut si dhe duke bere i bere operatorit PLUS nje subvencion te pakufizuar ne kohe ne kurriz te operatoreve te tjere, duke deformuar keshtu konkurrencen dhe ekuilibrat e krijuara ne treg.
- Ndaj AMC kerkoi ne komentet e saj qartesimin e ketij afati ne glide-pathin perfundimtar deri ne vendosjen e plote te simetrise se tarifave te terminimit midis operatoreve, gje e cila eshte lene serish e papercaktuar nga AKEP ne dokumentin final te analizes se tregut. Nje situatë e tille thellon me shume diskriminimin ne trajtimin midis operatoreve dhe shton mundesite per abuzim nga ana e PLUS.

c. Konvergimi midis tarifave te terminimit fiks dhe celular

- Sipas AMC ne kete ankim administrativ duhet konsideruar edhe nje problem tjetër qe ka te beje me konvergimin ndermjet MTR dhe FTR, duke ilustruar se Vendimet e KD-se te dates 06.11.2014 nder te tjera kane perkeqesuar edhe situaten krahasimore ndermjet MTR dhe FTR, pasi me aplikimin e tarifave te reja te terminimit celulare bazuar ne Vendimin final te AKEP Nr.2522, date 06.11.2014 konvergimi ndermjet tarifave te terminimit fiks-celular i cili pretendohet te arrihet, eshte larg ketij objektivi te AKEP pasi ndryshimi ndermjet ketyre tarifave ne fiks dhe mobile eshte i konsiderueshem.
- Nga krahasimi ndermjet tarifave te terminimit fiks-mobile, niveli i asimetrise ndermjet tarifave mobile te AMC dhe te Albtelecom ne fazen I ne segment lokal/jnfish dhe ne ate dyfish me tarifen e terminimit celular 2.66 lekjin jane perkatesisht 30% dhe 17%, ndersa ne fazen e dyte te tarifave te fiks ne segment lokal/jnfish dhe ne ate dyfish ky nivel shkon ne 41% dhe 16%

perkatesisht. Kur tarifa e terminimit celular sic ishte parashikuar te kalonte ne 2.04 lekjmin ne 1.04.2015, niveli i asimetrise me tarifate e fiks te fazes II ne segment lokalnjefish dhe dyfish shkon perkatesisht ne 23% dhe 9%. Ndersa me vendimin final te ndryshimit te tarifave te terminimit celular ne 1.48 lek/min tashme ne fuqi qe nga 1 Dhjetor 2014 ky nivel ka shkuar perkatesisht ne 6% dhe 34%

- Ne kete menyre evidentohet nje luhatje e ndjeshme ne nivelin e asimetrise se tarifave te terminimit fikscelular ne baze te vendimeve te AKEP per percaktimin e tarifate e terminimit celular. Sipas AMC kjo eshte edhe nje arsye tjeter, perse AMC ne komentet perkatese eshte shprehur se tarifate e terminimit ne rrjetet celular duhet te jene te orientuara ne kosto.

4.4. Tregu me pakice i sherbimeve te telefonise se levizshme

- AMC argumenton mbi zhvillimet pozitive ne tregun me pakice, duke e referuar se cdo nderhyrje me masa rregullatore ne kete treg, cilado qofte problematika per tarifate standarte prepaid dhe postpaid dhe ne diferencat *on net/off net*, sic eshte evidentuar dhe nga statistikat e publikuara nga AKEP ne lidhje me panoramen e tregut me pakice, trafiku on net perben peshen kryesore te trafikut total kundrejt trafikut off net. Ky fenomen eshte prezent tek te gjitha operatoret celulare ne treg, gje e cila evidenton nje sjellje te ngjashme te konkurrenteve midis tyre.
- Tregu me pakice evidenton vet-rregullim nga operatoret, pasi operatoret ofrojne paketa me minuta drejt rrjeteve te tjere ne volume te njejta, dhe trafiku dales i operatoreve ka pesuar rritje te ndjeshme.
- AMC ne qendrimin e saj eshte shprehur se konkurrenca ne tregun celular me pakice eshte efektive dhe per problematikat qe shfaqen eshte mese i mjaftueshem ligji i konkurrences ne adresimin e tyre duke bere qe detyrimet e reja te vendosura nga ana e AKEP ne tregun me pakice te jene te teperta dhe te panevojshme.
- Per sa i perket masave rregullatore per aplikim te njejte midis tarifave brenda dhe jashte rrjetit, AMC i konsideron si te teperta ne tregun me pakice, duke qene se karakterizohet nga nje nivel i konkurrences efektive midis operatoreve, ku cdo problematike e hasur eshte zgjidhur ne menyren e duhur nepermjet politikave komerciale qe ata kane ndjekur ne treg. Tregu me pakice eshte nje treg qe nuk ka nevojte per aplikim te masave te tjera rregullatore, pasi vet rregullohet ne menyre mese te kenaqshme.
- AMC sjell ne vemendje te AKEP se asimetria ndermjet Plus dhe tre rrjeteve te tjere, impakton negativisht edhe masat rregullatore ne tregun me pakice, pasi kjo vjen nga impakti qe rrjedh nga nivelet e ndryshme te tarifave te terminimit 1.48 lek/min dhe te 6.52 lek/min per operatorin PLUS, i cili shtremberon aftesite konkurruese midis operatoreve ne politikate e tyre komerciale ne tregun retail duke e percjelle si impakt negativ mbi diferencate midis tarifave me pakice *on net dhe off net*, duke sjelle nje menyre subvencionimi te ketyre tarifave nga ana e operatorit PLUS.
- Sipas AMC zgjidhja e ketij problemi ne nivel shumice eshte vendosja e simetrise se plote midis rrjeteve, e cila vendos operatoret ne kushte te barabarta konkurrenca dhe krijon stimul per reduktimin e diferences se

- tarifave on net -off net si dhe diferencen e tarifave off net kundrejt rrjetave te ndryshem (simetria e plote ka qene percaktuar nga AKEP me ane te metodologjise BULRAIC).
- Ndalimi i paketave tarifore me minuta brenda rrjetit do te ndikojte negativisht ne tregun shqiptar dhe me gjere ne shoqeri, pasi:
 - o Operatoret do te shtyhen per te rritur cmimet me pakice apo te ulin volumin e perdorimit;
 - o Perdoruesit do te ulin perdorimin e celulareve si dhe do te reduktohet kenaqesia e konsumatorit;
 - o Operatoret do te ulin fitimet e tyre, duke cuar ne ngadalesim te zhvillimit dhe te investimeve.
 - Gjithashtu keto masa ndikojne vecanerisht negativisht ne sherbimet postpaid ne lidhje me bizneset, te cilat karakterizohen nga aspekte te individualizuara dhe nga ekzigjenca specifike kundrejt sherbimeve te tjera, dhe ne lidhje me te cilat AKEP ne pergjigjen e saj zyrtare me ane te pastes elektronike tek AMC date 20.11.2014, ka shprehur disa paqartesi ne lidhje me aplikimin e masave rregullatore ne lidhje me keto sherbime.
 - Per sa me siper AMC ne kete ankim administrativ gjykon qe masat e percaktuara nga AKEP me ane te vendimit nr.2522 date 6.11.2014 per detyrimin e operatoreve per aplikim te njejte te tarifave me pakice brenda dhe drejt rrjeteve te tjera jane shtrenguese duke ngushtuar ne kete menyre hapesirat e operatoreve ne politikat e tyre komerciale dhe tarifore per t'iu pergjigjur sa me mire nevojave dhe ekzigjencave te kategorive te ndryshme te perdoruesve fundore, dhe ne vecanti per kategorine e perdoruesve postpaid.
 - Ndaj AMC mendon se eshte mese e mjaftueshme qe t'i lihet dore e lire tregut dhe operatoreve ne treg me politikat e tyre komerciale sic kane operuar deri tani ne reduktimin e problemit te diferencave midis tarifave me pakice (on net/off net) duke qene kunder aplikimit te ketyre masave.
 - Gjithashtu, operatoret tashme kane filluar te aplikojne dhe ndryshime strukturore ne ofertat e tyre ne tregun retail duke barazuar ne kete menyre tarifat brenda dhe jashte rrjetit, apo duke perfshire ne te njejten oferte minuta si brenda dhe jashte rrjetit, ashtu sic eshte evidentuar dhe ne dokumentin final te analizes se tregut nga ana e AKEP gjate pershkrimin te ofertave te operatoreve.
 - Per kete arsye, AMC thekson qe masat rregullatore ne tregun me pakice, dhe per pasoje dhe ato ne lidhje me kohezgjatjen e ofertave nuk jane te nevojshme, pasi eshte vet konkurrenca mjeti i duhur dhe me efikas ne kete treg per zgjidhjen e problematikave te ndryshme qe jane krijuar apo mund te krijohen ne te ardhmen.
 - Per sa eshte permendur dhe ne komentet e mesiperme per masat e percaktuara nga ana e AKEP per adresimin e problematikes on net/off net, keto masa jane te teperta ne nivel pakice, duke qene se ky treg eshte i derregulluar, dhe per rrjedhoje keto masa rregullatore jane nje barre e tepert per operatoret dhe ngushtim i hapesirave qe ata do te kene ne politikat e tyre komerciale dhe tarifore duke filluar nga aplikimi i ketyre masave nga data 1 Janar 2015.
 - Me specifikisht, AMC eshte shprehur ne komentet e saj kunder:
 - o kufizimit apo rregullimit te menyres se aplikimit te ofertave promocioneve qe bejne operatoret me qellim rritjen e perdorimit te paketave standarte dhe perfitimeve nga paketatjarifat standard;

- o rishikimit te tarifave te planeve standarde dhe perdorimit te ofertave, pasi paraqitja e te gjitha ofertave retail ne AKEP eshte kryer dhe kryhet rregullisht nga ana AMC, si dhe ne sistemin on line te raportimeve te AKEP, ne te cilin publikohen te gjitha llojet e ofertave qe hidhen ne treg, cdo lloj ndryshimi qe behet ne keto oferta, ne lidhje me skadencen e ofertes apo ndryshime te tjera ne cmim apo ne skontot e kryera;
- Ndersa, per sa i perket detyrimit te mos- diskriminimit te brendshem i perfshire si detyrim ne nivel shumice, AMC e konsideron ate si mase te tepert, jo te drejte dhe jo proporcionale rregullatore. Zgjidhja me e drejte e cila do te reduktoje diferencat ne tarifat on net dhe off net midis tyre eshte lenia e lire tregut me pakice per te adresuar kete ceshtje, sic eshte evidentuar dhe ne paketat tarifore te operatoreve ne te cilat kemi nje parafrim te tyre, mos dallim midis minutave brenda dhe jashte rrjetit.

4.5. Konkluzionet e ankimit të AMC

AMC, pas argumentimit në këtë material shkresor që mbështet ankimin administrativ, kërkon:

1. Shfuqizimin e akteve administrative: Vendimit të AKEP Nr.2522, datë 06.11.2014 "Për Miratimin e dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme - Dokumenti Përfundimtar"; Vendimit të AKEP Nr.2525; datë 06.11.2014 për "Përcaktimin e sipërmarresit Albanian Mobile Communication sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të Albanian Mobile Communications dhe vendosjen e masave rregulluese", dhe heqjen e asimetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare midis operatorëve celularë;

2. AKEP të fillojë përgatitjen e një modeli të ri kostoje në bashkëpunim me operatorët e tjerë mobile, për llogaritjen dhe përcaktimin e kostove të terminimit në rrjetet celulare.

3. Shoqeria AMC kërkon shfuqizimi e detyrimit për accounting separate cost, i cili ka të bëjë me kontrollin e vendosjes së tarifave të terminimit nëse janë abuzive. Ndërkohe këto tarifa sipas vendimit të AKEP rregullohen me anë të metodës benchmark pure LRIC dhe kanë arritur nivelin më të ulët të mundshem.

4. Pezullimin e Vendimit të AKEP nr.2525, datë 6.11.2014 Për "Përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communications Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të levizshëm Albanian Mobile Communications dhe vendosjen e masave rregulluese, sipas të cilit, AMC ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarresit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare:

1. Tarifat e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare nuk duhet të jenë më të larta se tarifat e thirrjeve brenda rrjetit Albanian Mobile Communications;

2. Sasia e minutave brenda rrjetit Albanian Mobile Communications të perfshira në oferta/pagese fikse të paketave tarifore nuk duhet te jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;

3. Përcaktimet e pikave 1 dhe 2 me sipër aplikohen për të gjitha paketat tarifore standarte, ofertat, shportat, opsionet dhe skontot të ofruara për pajtimtarët.

dhe në rastin më të keq të mos marrjes parasysh të kërkesave dhe argumentave të paraqitura që lidhen me thelbin e vendimmarrjes, AMC kërkon shtyrjen për **hyrjen në fuqi të tyre në datën 1 Korrik 2015**, duke e vlerësuar si periudhë të nevojshme që shoqëria AMC do të marrë masat për implementimin e tij në kohë.

5. Albtelecom sh.a në ankimin e depozituar ka kërkuar revokimin e pjesëshëm të Vendimeve nr. 2522 dhe 2524 datë 6.11.2014, që kanë lidhje me miratimin e dokumentit të analizës së tregut celular dhe vendimin për Fuqinë e Ndjeshme në Treg dhe masat rregulluese për Plus Communication sh.a. Albtelecom ankimon këto dy vendime duke kërkuar ndryshimin e pikës 3.4 ii) të VKD 2524 datë 6.11.2014 në lidhje me tarifën e terminimit në rrjetin e operatorit PLUS në vlerën që të reflektojë parimin e orientimit në kosto në simetri me operatorët e tjerë, dhe në mënyre alternative; në vlerë maksimale ku të merret si referencë benchmark-u europian.

5.1. Dakortësi për masat për reduktim të MTR dhe mos-diskriminimin on-net/off-net

Albtelecom nëpërmjet shkresës së ankimit konfirmon dhe njëherë qëndrimin e tij të shprehur në komentet e bëra gjatë konsultimit publik të dokumentit "Analiza e tregut të telefonise celulare", se në parim masat e vendosura në tregun me shumice (si reduktim i MTR-ve), dhe atë të vendosura në tregun me pakicë (si implementimi i rregullit të mosdiskriminimit të tarifave me pakicë' apo kufizimet në mënyrën e aplikimit të ofertave/promocioneve) janë masat e duhura rregullatore/ligjore dhe përbëjnë një domosdoshmëri për adresimin e problemeve me konkurrencën në tregun e telefonise celulare, veçanërisht minimizimin/eliminimin e praktikës antikonkurruese të diferencimit të thirrjeve on-net/off-net.

5.2. Kundërshtime në lidhje me asimetrinë e tarifës së terminimit në rrjetin PLUS

Albtelecom shpreh kundërshtinë/ankimin e tij lidhur me ruajtjen e asimetrisë për operatorin PLUS, duke sjellur në vëmendje të AKEP se ruajtja e asimetrisë për operatorin PLUS është në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr. 9918, pika 3, e) duke arsyetuar se, tarifa e terminimit në rrjetin publik të lëvizshëm të Plus 6,52 lek/min nga 01/12/2014, e përcaktuar me Vendimin nr 2524 është në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr 9918, i ndryshuar, të cilat parashikojnë se në rregullimin e tarifave, AKEP vlerëson praktikën me të mira dhe tarifën mesatare të vendeve të BE-së. Në vijim parashtrihen argumentet thelbësore ku Albtelecom mbështet ankimin e tij administrativ:

- a. Ligji nr 9918 dt. 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 102/2012, neni 7 "Objektivat

- Rregullatore", duke cituar pikën 1, sipas të cilës, AKEP merr parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit European dhe BEREC. Gjithashtu Ligji nr 9918, parashikon ne nenin 57, pika 2, se AKEP në rregullimin e tarifave mund t'i referohet praktikës më të mirë të vendeve të BE-së, apo tarifave mesatare të BE.
- b. Rekomandimi i Komisionit European 2009/396/EC specifikon se shtetet anëtare të BE duhet që deri në 31 dhjetor të vitit 2012 të kenë implementuar tarifa të orientuara në kosto të një operatori eficient sipas metodës së kostos LRIC i pastër. Nderkohë, rekomandimi përcakton se shtetet që kanë kufizime momentale për implementimin e modelit duhet të përdorin metodat e benchmarking me tarifën e terminimit të shteteve ku aplikohen sipas këtij modeli.
 - c. Albtelecom e gjen të pambeshtetur përcaktimin nga AKEP të tarifës së terminimit të Plus 6.52 lek/min. Në çdo rast asimetrie ajo nuk mund të jetë më e lartë se referencat në benchmarkun European. Përdorimi si benchmark i tarifës mesatare re ponderuar të terminimit për 34 vënder të Europës në Janar 2013' prej 2.04 lek/min (propozuar dhe trajtuar me gjerësisht në komentet tona), është e vetmja tarifa e arsyeshme me një nivel asimetrie deri diku të pranueshëm afërsisht 38%.
 - d. Gjithashtu, përcaktimi i tarifës së terminimit të PLUS në asimetri 340% me operatorët e tjerë celularë nuk favorizon apo shëndosh konkurrencën në tregun e telefonisë celulare, nuk garanton kushte të barabarta të konkurrencës midis operatorëve në treg, si dhe përkeqëson balancën neto mes Albtelecom dhe Plus, duke e sanksionuar të paktën Albtelecom si "net payer" kundrejt Plus, pavarësisht sasive të trafikut të interkoneksionit të shkëmbyera respektivisht midis tyre.
 - e. Shtojmë këtu faktin se, AKEP ka përcaktuar detyrimin e të katër operatorëve për aplikimin e detyrimit për mos-diskriminimin e tarifave me pakicë (on-net/off-net) dhe aplikimi eficient, për të garantuar atë çka do të arrihej nëpërmjet këtij rregulli për konkurrencë efektive, do të kërkonte normalisht simetri të tarifave të terminimit për të katër operatorët për të cilët do të aplikohet ky rregull. Gjithashtu simetria e tarifave të terminimit do të përbente lehtësi në implementimin, garantimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij rregulli duke sjellë kështu efektet që priten në konkurrencën në tregun e telefonisë celulare. Për më tepër, do të ishte më e lehtë edhe garantimi i një sasive të njëjtte minutash on-net dhe off-net të përfshira në oferta, promocione, etj.
 - f. Po ashtu, sjellja e tarifave të terminimit të gjithë operatorëve celularë në simetri të plotë duke ruajtur asimetrinë vetëm për operatorin PLUS, në një kohë kur aplikimi i rregullit për mos-diskriminim të brendshëm është i detyrueshëm për të gjithë operatorët në treg, pa sjellë një sërë komplikimesh/nderlikimesh në aplikimin e këtij rregulli duke rënduar

operatorët të jenë në limitet e respektimit të parimeve që ndalojnë praktikën e ofrimit të shërbimeve në kosto.

5.3. Kundërshtime në lidhje me detyrimin e ndarjes së llogarive

- a. Në seksionin përkatës VI.1 të dokumentit të Analizës së Tregut-versioni final për përcaktimin e masave rregulluese në tregun e terminimit të thirrjeve parashikohet se, në ndryshim nga operatorët e tjerë, përveçse për PLUS ruhet një asimetri e thellë, operatori PLUS nuk është as subjekt i detyrimit për ndarjen e llogarive, nderkohe që për nga mënyra e përcaktimit të tarifave të terminimit, do duhej të ishte krejtësisht e kundërt; Kështu, AKEP ka përcaktuar tarifën e terminimit për Altelecom dhe operatorët e tjerë duke konsideruar rekomandimet e KE dhe parimin e orientimit në kosto duke marrë si referencë tarifën mesatare të vendeve që kanë aplikuar modelin "LRIC" të paster, model i cili pre-uzon koston e shërbimit të një operatori eficient, e mbështetur kjo sipas përcaktimeve që parashikon Ligji 9918. Ndërsa për PLUS tarifën e terminimit nuk është e orientuar në kosto, është e pambështetur në referencë ligjore apo në benchmark europian dhe si e tillë, duke qenë se tarifa e PLUS nuk i referohet kostove të një operatori eficient, është pikërisht domosdoshmëri për PLUS që të jetë subjekt i detyrimit për llogaritjen e kostove dhe ndarjen e llogarive.
- b. Altelecom kundërshton aplikimin e detyrimit për llogaritjen e kostove dhe ndarjen e llogarive, duke kërkuar që të behen ndryshimet përkatëse në dokumentin e Analizës dhe Vendimin përkatës që Altelecom të mos jetë subjekt i detyrimit për ndarjen e llogarive, ose se paku të mundësohet shtyrja në kohë për aplikimin e përcaktimeve sipas VKD nr. 2406 dt. 26.12.2013 për realizimin e një projekti të tillë të komplikuar siç është ky i "*Ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostove*" edhe për vende të tjera shumë me të zhvilluara dhe të konsoliduara.

Në përfundim Altelecom thekson se ruajtja e asimetrisë për PLUS dhe përcaktimi i tarifës së terminimit 6.52 lek/min, në nivel asimetrie prej 340% me operatorët e tjerë celularë në treg nuk krijon një premisë reale të zgjidhjes së problematikave të konkurrencës në tregun e telefonisë celulare.

Altelecom kërkon që AKEP të rishikojë dhe të rivlerësojë tarifën e terminimit në rrjetin publik të levizshëm të Plus të përcaktuar në vendimet nr.2522 dhe nr.2524 të datës 06.11.2014.

5.4. Kërkesat e Altelecom

Si përfundim, në ankimin administrativ të paraqitur në referencë me nenin 138, pika 1 dhe nenin 146, të KPrA, pika b, Altelecom kërkon nga AKEP:

- a. Modifikimin e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.2522, datë 06.11.2014 për "Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut celular, " tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë

së levizshme-Dokumenti Perfundimtar", në lidhje me rishikimin në seksioni VI. 1 të tarifës së terminimit për operatorin PLUS, si dhe;

- b. Modifikimin e VKD Nr.2524 datë 06.11.2014 për "Përcaktimin e sipërmarresit Plus Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të levizshem të Plus dhe vendosjen e masave rregulluese" për ndryshimin e pikës 3.4 ii) në lidhje me tarifën e terminimit në rrjetin e operatorit PLUS në vlerën që të reflektojë parimin e orientimit në kosto në simetri me operatorët e tjerë, dhe në mënyre alternative; në vlerë maksimale ku të merret si referencë benchamrk-u europian.

6. Plus Communication sh.a. në ankimin e depozituar ka kërkuar revokimin e Vendimeve nr.2522 dhe nr.2524 datë 6.11.2014, që kanë lidhje me miratimin e dokumentit të analizës së tregut celular dhe vendimin për Fuqinë e Ndjeshme në Treg dhe masat rregulluese për Plus Communications sh.a. Plus nëpërmjet ankimit kërkon që AKEP të ndryshojë dokumnetin e analizës së tregut duke përcaktuar tregun me pakicë të sherbimeve në rrjetet celulare si treg të justifikueshem për nderhyrje ex-ante dhe shpalljen e operatorëve AMC, Vodafone dhe Albtelcom si operator me fuqi të ndjeshme në këtë treg si dhe heqjen e detyrimit për eliminimin e diferencimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit për operatorin PLUS. Pretendimet kryesore të paraqitura nga Plus Communication, në mënyre të përmbledhur, referohen si në vijim:

- PLUS vlerëson domosdoshmërinë e aplikimit të masave rregullatore për të korrigjuar problemet e ndjeshme të konkurrencës në tregun e telefonisë të levizshme të konfirmuara edhe nga institucione të tjera shtetërore, por edhe nga AKEP në analizën celulare.
- Gjithashtu, PLUS konsideron se marrja e masave në tregun me pakicë bazuar në detyrimin e mosdiskriminimit nën 39, 51 i Ligjit 9918 , pika 4 e VKD nr. 2524 është mjeti kryesor i cili do të mundësojë korrigjimin dhe ndalimin e deformimeve të konkurrencës të konstatuara nga AKEP dhe AK, duke krijuar kushtet për një konkurrencë eficientë.
- Në të njëjten kohë, PLUS kërkon vendosjen e këtij detyrimi në tregun me pakicë të thirrjeve vetëm për operatorët e medhenj, të cilët duhet të shpallen si operatorë me fuqi të ndjeshme në këtë treg, pasi deformimi aktual në tregun e telefonisë së levizshme në Shqipëri është rrjedhojë direkte e strategjive tarifore të këtyre operatoreve që nga viti 2011. Operatori PLUS, bazuar në treguesit e trafikut off-net dhe të dhenat e tjera publikuar në Analizë, ka ofruar në përputhje me mundësitë e tij financiare, tarifa me pakicë më të lira se konkurrentet në këtë treg dhe nëpërmjet paketave/ofertave të ofruara është përpjekur të orientojë pajtimtarët e tij të kryejnë thirrje jashtë rrjetit.

Ndaj në referencë me sintezën e përgjithshme të paraqitur nga PLUS, për të mbështetur pretendimet e paraqitura sipas të cilave kërkon revokimin e pjesës së VKD nr. 2522 dhe 2524 datë 06.11.2014, për sa i përket vendosjes së detyrimit për mosdiskriminim të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit për operatorin PLUS, duke argumentuar se vendosja e këtij detyrimi për PLUS është e pajustificuar me të dhënat e tregut dhe e pabazuar në kuadrin rregullator dhe ligjor në fuqi si dhe praktikën BE, por kërkon përcaktimin e tregut me pakicë të sherbimeve në rrjetet celulare si treg të justifikueshem për nderhyrje ex-ante dhe shpalljen e operatorëve

AMC, Vodafone dhe Albtelcom si operator me fuqi të ndjeshme në këtë treg në përputhje me Nenin 56 pika 2 të Ligjit nr.9918, në analogji të plote me komentet e dërguara për dokumentin e analizës dhe percaktimet e tij në fund të procesit të këshillimit publik, sjell ne vemendje të AKEP se:

6.1. Kuadri ligjor në fuqi si dhe si dhe praktikat e BE-së, përcaktojnë se masat rregullatore duhet të vendosen vetëm ndaj operatoreve të mëdhenj, veprimtaria e të cilëve ka shkaktuar deformimet e konkurrencës në treg, duke paraqitur referenca ligjore perkatëse në mbështetje të pretendimeve të paraqitura.

- i. Sipas pikës 2 të Nenit 7 të Ligjit nr.9918, "rregullimi në fushën e komunikimeve elektronike duhet të jetë në masën e nevojshme për të parandaluar deformimet e konkurrencës dhe për të arritur objektivat e këtij ligji", pra ligji parashikon rregullimin vetëm të veprimtarive të cilat kanë ndikim në treg dhe deformatojnë konkurrencen e lirë dhe efektive. Gjithashtu, në Nenin 8, të këtij Ligji përcaktohet se "AKEP ndërmerret dhe percakton masa mbrojtëse ndaj sipermbrojtësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike për të mos lejuar praktika antikonkurrense". Në nenin 34 Analiza e Tregut, pika 5 shprehet se "Detyrimet e vendosura në përputhje me këtë nen bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe duhet të jenë proporcionale e të justifikuar nga pikepamja e objektivave rregullatore të vendosura në nenin 7 të këtij ligji". Pra aplikimi i masave rregullatore duhet të jetë proporcional dhe i justifikuar në përputhje me problematikën e evidentuar, dhe me shkakun e krijimit të deformimeve të konkurrencës në treg dhe nuk mund të vendosen masa rregullatore ndaj operatorëve të cilët nuk kanë shkaktuar dhe nuk mund të shkaktojnë deformime në treg.
- ii. Nën të njëjtën logjikë, edhe Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin nr.303 datë 16.01.2014 "Per mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare ndaj ndermarrjes "Vodafone Albania Sh.A." i ka rekomanduar AKEP:
 - Te detyrojë zvogelimin real të diferencës së tarifave off-net/on-net brenda dhe jashtë paketave dhe planeve tarifore specifike për operatorët e konsoliduar në treg.
 - Te ulë ndjeshëm koston e terminimit për operatorët e vegjel ndaj operatorëve të mëdhenj në këtë treg, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun përkatës;

Gjithashtu me këtë Vendim AK ka konstatuar se: *Diferencimi i cmimeve brenda me jashtë rrjetit mund të perdoret si një mekanizëm i mbylljes së tregut nga operatorët e mëdhenj; për operatorët e vegjel të cilët mund të rrezikojnë daljen nga tregu përkatës, dhe ky fakt përben një shqetësim për mirëfunksionimin e tregut në periudhë afatgjatë.*

Pra, diferencimi i cmimeve deformon konkurrencen në treg, vetëm kur perdoret nga operatorët e mëdhenj. Operatorët e vegjel si PLUS me vetëm 6 % të tregut të perdoruesve dhe 5 % të të ardhurave duke qenë në vitin e 4 të veprimtarisë tregtare, jo vetëm që nuk mund të përfitojnë nga ky mekanizëm, por ndikimi i aplikimit të kësaj strategjie është aq i madh nga

operatorët e mëdhenj sa mund të rrezikojnë edhe daljen nga tregu të operatorit PLUS.

- iii. Keto problematika në tregun e komunikimeve elektronike, janë evidentuar dhe është kërkuar marrja e masave të menjehershme efektive edhe në dokumentat e mëposhtem:
- Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë "Për Vlerësimin e Veprimtarisë së AKEP Vitin 2013" datë 19.06.2014;
 - Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë "Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013" datë 29.05.2014;
 - Vendimi Nr.303 datë 16.01.2014 i Autoritetit të Konkurrencës ku janë konfirmuar deformimet e konkurrencës në treg, dhe janë rekomanduar masat përkatëse. AKEP ka konfirmuar këtë situatë problematike edhe në Vendimet e Analizës Celulare.

Sipas Plus Communication, në të gjitha keto dokumente, konfirmohet qartazi se strategjia e ndjekur nga operatorët e mëdhenj ka sjellë efekte negative për konkurrencën ndaj operatorit Plus, nëpërmjet aplikimit të diferencimit të cmimit të thirrjeve brenda me jashtë rrjetit, i cili është përdorur si një mekanizëm i mbylljes së tregut nga operatorët e mëdhenj duke sjellë rrezikun për daljen nga tregu të operatorit Plus. Kjo strategji nuk është penguar aspak nga politika e ndjekur në të njëjtën periudhë nga AKEP, pasi ulja e tarifave të terminimit nga Plus është injoruar nga operatorët e mëdhenj duke e bërë totalisht inefficente politikën rregulluese të AKEP dhe duke e shtuar tregun në situatën totalisht jo-konkurrense në të cilën ndodhet, me parametra të pakrahasueshëm me asnjë treg të ngjashëm evropian.

- iv. Literatura ekonomike ndërkombëtare, mban qëndrimin se diskriminimi mbi baze cmimi pakice për shërbimet on/off net, mund të shërbejë si një barriere strategjike në tregjet e pakices së telefonisë celulare dhe mund të jetë një sjellje anti-konkurrense vetëm në rast se aplikohet nga operatori me pozite dominuese.

Sipas dokumentit të ERG i cili reflekton situatën në tregun e telefonisë celulare në Shqipëri: *Praktikat e diferencimit on-net/off-net 2 krijojnë problem për konkurrencën në rastin ekstrem kur c; mimi on-net janë më të ulët se MTR për operatorët dominues. Kur Operatorët e vegjël përpiqen të kalojnë efektin "club" (barrierën) nëpërmjet uljes së cmimeve off-net që pajtimtarët e tyre ta krahasojnë me c; mimi on-net të operatorëve të mëdhenj, duhet të paguajnë koston e lartë të MTR, ndërkohë që marrin një të ardhur shumë të ulët nga cmimi me pakice. Kur MTR është më i ulët se c; mimi on-net të operatorit të madh (gjithmone kemi parasysh 9 mimi nga ofertat pasi të përdoren gjërat), atëherë operatori i vogël është i detyruar të pësojë humbje për thirrjet e tij jashtë rrjetit nëse do të jetë konkurrense. Një sipërmarrje duhet të zotërojë një pozite dominuese, për të mundësuar krijimin e efekteve të ndjeshme të grupit ("club effects"), në atë masë sa të jetë në gjendje të përjashtojë konkurrentet nga tregu përkatës.*

Për sa me sipër, precedentet e Autoritetit Francez për Mbrojtjen e Konkurrencës shprehin se performancimi i efekteve të grupit ("club effects") vjen si rezultat i plotësimit të dy kritereve:

- disproporcioni midis pjeses se tregut te zoteruar nga operatorët aktive ne treg;
 - dallimi/diferencimi ne tarifat e aplikuara brenda-rrjetit (*on net*) dhe me ate jashte rrjetit (*off net*).
- v. Masat per detyrimin per aplikim tarifash te njejta per thirrjet brenda dhe jashte rrjetit, jane aplikuar edhe ne vende te tjera vetem per operatorët me pozite dominuese ne treg. Ne pretendimet e tij, Plus¹ ne kete pike pershkruan praktikate ne Slloveni, Kenia, Singapor dhe Turqi.

6.2. Deformimet e konkurrences ne tregun me pakice

Plus pretendon se deformimet ne tregun me pakice jane shkaktuar vetem si rezultat i strategjive te operatoreve te medhenj dhe per kete Plus ka referuar te njejtat te dhena dhe tabela krahasuese te referuara edhe ne komentet e derguara ne AKEP, per te cilat eshte mbajtur qendrimi perkates ne ne Dokumentin Final te analizes te telefonise se levizshme, (aneks 2) miratuar me VKD nr.2522, date 06.11.2014, dhe publikuar ne faqen e Internetit te AKEP dhe ne menyre te permblodhur referohet:

- Thirrjet brenda rrjetit vazhdojne te perbejne 95-97% te totalit te thirrjeve dalese celulare kombetare per operatorët AMC dhe Vodafone, duke vazhduar tendencen e viteve te fundit dhe perdorimin e madh te paketave tarifore me tarifa shume te uleta per thirrjet brenda grupeve te mbyllura brenda rrjetit.
- Keto te dhena per operatorët dominant ne Shqiperi, perbejne nje rast te paprecedent, unik ne bote ku Vodafone prej vitit 2011 e ne vazhdim, ka 97% te trafikut on net dhe vetem 3% off net, pra 32 here me te larte se trafikun off-net, ndersa AMC ka 95% on net dhe 5% off net, ne nje kohe kur mesatarja e trafikut on-net ne vendet e BE eshte maksimalisht 70% dhe raporti on-net/off-net eshte ne kufijte 2- 2.5 here.
- Edhe nga te dhenat per 6 mujorin e pare te vitit 2014 nga raporti i trafikut te Plus me operatore te tjere, veme re se raporti i proporcionit on-net nuk ka ndryshuar krahasuar me vitet e tjera, nese ne kete raport nuk perfshihen te dhenat e trafikut nderkombetar i cili ka patur nje rritje shume te larte per kete periudhe. Per 6 mujorin e I te vitit 2014, trafiku on-net i Vodafone dhe AMC rezulton ne te njejtin nivel trafiku brenda rrjetit, Vodafone 96% dhe AMC 94 %.
- Plus informon se, AK duke e konsideruar ankimimin e PLUS ne lidhje me abuzimin me pozitën dominuese ne treg te Vodafone per kete periudhe si te bazuar ne fakte e ne ligj, aktualisht eshte duke hapur nje hetim paraprak ndaj VF dhe konkretisht referon Vendimin nr.336, date 11.11.2014 te Autoritetit te Konkurrences, i cili ka vendosur hapjen e hetimit paraprak ndaj ndermarrjes Vodafone Albania SHA, per periudhen e hetimit 1 Janar 2013 - 30 Qershor 2014;

¹ Plus ne kete pjese i referohet dokumentit: On-net/Off-net Price Differentiation: Review of International Precedent. Telecommunications Management Group, Inc.

6.3. Strategjia tarifore e PLUS nuk mund të ndikojë e të sjellë deformimin e konkurrencës në treg e për rrjedhojë është e pajustificuar vendosja e masave rregullatore ndaj PLUS dhe në mbeshtetje të këtij pretendimi, referon:

- Në lidhje me aplikimin e diferencimit të thirrjeve, rezulton te jetë e ndryshme pozita dhe ndikimi i një operatori të ri si Plus i cili, në krahasim me operatorët e mëdhenj, ka një pjesë tregu shumë të vogël e të kufizuar dhe, për pasojë, nuk ka mundur në këto vite dhe nuk mund të perfitojë edhe në të ardhmen nga avantazhet e diferencimit të cmimeve në mes të thirrjeve *on-net* dhe *off-net*. Rrjedhimisht PLUS, nuk mund të ndikojë në mënyrë absolute në deformimet e konkurrencës në treg për këtë arsye nuk ka shkak vendosja e masave rregullatore ndaj një operatori të vogël dhe pa mundësi ndikimi në treg.
- Bazuar në të dhënat statistikore të AKEP, prej vitit 2010 (konkretisht fundi i vitit 2010), vit në të cilin PLUS ka hyrë komercialisht në treg, pavarësisht se AKEP ka ulur MTR për të gjithë operatorët, duke lejuar edhe asimetri në favor të hyresve të rinj në treg, PLUS, nuk ka mundur të rrisë pjesën e tij në treg, e madje treguesit kryesorë janë reduktuar për PLUS.
- Gjithashtu tarifat jashtë rrjetit tepër të larta të operatorëve të mëdhenj asnjëherë nuk e kanë pasqyruar uljen graduale të tarifave të terminimit duke injoruar plotësisht politikën rregulluese të AKEP, por kanë qëndruar të pandryshuara për një periudhë disa vjecare duke sjelle për shkak edhe të ofertave të aplikuara vetëm brenda të njëjtit rrjet dhe kycjen e pajtimtarëve.

6.4. Tregu me pakicë celular plotëson testin e 3 kriterëve për treg të justifikueshëm/dyshuar për nderhyrje ex-ante dhe operatorët AMC, Vodafone dhe Eagle Mobile (i bashkuar Albtelecom) duhet të shpallen operatorë me fuqi të ndjeshme në këtë treg.

Për të mbështetur këtë pretendim, Plus ka sjellë arsyetimin e tij për testin e tre kriterëve, duke i analizuar me radhe, trajtim i bere edhe në komentet perkatëse në fund të këshillimit publik, referuar me sipër.

- PLUS gjykon dhe argumenton se përveç: kriterit I Prezenca e barrierave të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes, i cili AKEP gjykon se plotësohet, plotësohen edhe dy kriteret e tjerë duke e vlerësuar tregun e pakices si treg të mundshëm për nderhyrje ex-ante.
- PLUS kërkon që masat në tregun me pakicë, në zbatim të Nenit 56 pika 2 të Ligjit nr.9918, nuk duhet të aplikohen për të, por vetëm për operatorët e tjerë, AMC, Vodafone dhe Eagle Mobile (I bashkuar Albtelecom), të cilët nga të dhënat statistikore dhe pjesët e tregut të tyre duhet të vlerësohen me fuqi të ndjeshme në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, treg i cili plotëson testin e tre kriterëve dhe për të cilin duhen të aplikohen nderhyrje ex-ante.

6.5. Kërkesat e PLUS

Bazuar në pretendimet e paraqitura, të mbështetura dhe të argumentuara në mënyrë të përsëritur dhe pothuajse në mënyrë analoge me komentet e derguara në fund të procesit të këshillimit publik për dokumentin e analizës celulare, Plus Communication i kërkon AKEP që në reference me Nenet 7, 8, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 39, 53, 55, 56, 57, 58, 59, 61, 114 e vijues i Ligjit nr. 9918 dhe Nenit 9 e

vijues, 66 e vijues, neni 116, 137, 138.1 e vijues i Ligjit Nr. 8584 datë 12.05.1999 të Kodit të Procedurave Administrative, të marrë në konsideratë ankimin e Plus Communication Sh.A. dhe të vendosë:

1. Pranimin e ankimit administrativ të PLUS;
 2. Revokimin e pjesshëm të Vendimit të Këshillit Drejtues nr.2522, date 6.11.2014 Për "Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së levizshme-Dokumenti Përfundimtar", në lidhje me:
 - përcaktimin e tregut me pakicë të shërbimeve në rrjetet celulare si treg të justifikueshem për nderhyrje ex-ante dhe shpalljen e operatorëve AMC, Vodafone dhe Albtelecom si operator me fuqi të ndjeshme në këtë treg;
 - heqjen e detyrimit për eliminimin e diferencimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit për operatorin PLUS.
 3. Revokimin e pjesshëm të Vendimit Nr.2524, datë 6.11.2014 Për "Përcaktimin e sipermarrësit PLUS Communication Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të levizshëm PLUS Communication dhe vendosjen e masave rregulluese", dhe konkretisht pikën 4 të këtij Vendimi në lidhje me vendosjen e detyrimit për PLUS për mosdiskriminimin e thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit.
7. AKEP në muajt Nëntor-Dhjetor ka zhvilluar takime me operatorët celularë për të dhënë sqarime për implementimin e detyrimit të mos-diskriminimit midis tarifave të thirrjeve on-net dhe off-net të vendosura me Vendimet nr.2522-2526, datë 6.11.2014 për të katër operatorët celularë. Nga takimet u evidentuan disa çështje, ku më të rëndësishmet ishin:

7.1. Afati i aplikimit

Sipas operatorëve afati i vendosur nga AKEP për fillimin e implementimit të këtij detyrimi, data 1.01.2015, ishte teknikisht e përealizueshme për shkak të specifikave të muajit Dhjetor ku operatorët nuk mund të kryejnë ndryshime në sistemin e faturimit dhe ndryshimet e mëdha në planet tarifore imponojnë marrjen e një sërë masave për implementimin e tyre që kërkon kohë më të gjatë.

7.2. Trajtimi i pajtimtarëve me kontratë dhe vlefshmëria e ofertave/paketave

Pajtimtarët me kontratë kanë pjesë të kontratës planin tarifor dhe ndryshimi i tij duhet të kryhet vetëm pas njoftimit 1 muaj në avancë nga aplikimi i tarifave të reja. Njëkohësisht një pjesë e madhe e pajtimtarëve me kontratë janë me kontrata specifike të individualizuara dhe kishte propozime që tarifat e këtij grupi pajtimtarësh të mos jenë pjesë e detyrimit të mos-diskriminimit on-net/off-net, pasi biznese/institucione përfitojnë nga skontot e ofruara dhe mund të trajtohen si shërbime jo-të disponueshme për publikun (VPN-Virtual Private Networks).

Njëkohësisht një pjesë e pajtimtarëve me parapagim blejnë oferta/opsione që kanë vlefshëmri përtej datës së fillimit dhe normalisht ato duhet të konsumohen sipas termave dhe tarifave në kohën e blerjes.

7.3. Nevoja për sqarime në lidhje me opsione të ndryshme tarifore

Operatorët ngritën një sërë pyetjesh në lidhje me mënyrën e aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net si:

- Përfshirjen ose jo të sasive të thirrjeve on-net në shportat e thirrjeve kombëtare, krahas sasisë së veçantë të thirrjeve on-net;
- Përfshirjen ose jo të thirrjeve drejt destinacioneve fikse kombëtare dhe/ose ndërkombëtare në shportat e thirrjeve on-net/off-net;
- Lejimin ose jo të skontove drejt një apo disa numrave brenda rrjetit etj.

AKEP ka dhënë disa sqarime paraprake për operatorët në takime ose nëpërmjet komunikimit me shkrim, por duke theksuar se do të japë sqarime përfundimtare për të katër operatorët pas trajtimit të ankimeve administrative të operatorëve për vendimet e datës 6.11.2014.

- 8.** AKEP në vijim të ankimeve të operatorëve dhe diskutimeve për implementimin e detyrimit të mos-diskriminimit on-net/off-net kërkoi informacion shtesë nga operatorët për trafikun on-net/off-net dhe detaje për numrin e pajtimtarëve me kontratë. Nga informacioni i përditësuar për vitin 2014 rezultoi se:
 - 8.1. Proporcioni mesatar vjetor i trafikut on-net ndaj totalit të thirrjeve dalëse për dy operatorët e mëdhenj ishte 87-88% në 2014 krahasuar me 92-93% në 2013. Tendenca e këtij proporcioni ka qenë në rënie në 2014, duke arritur në 82-83% në Dhjetor 2014 dhe 79%-(AMC?) në Janar 2014
 - 8.2. Tendenca e sasisë së trafikut off-net vazhdon të jetë në rritje për të katër operatorët: 100-223% rritje trafiku off-net Dhjetor/Janar 2014. Sasia e trafikut off-net të dy operatorëve më të mëdhenj në këtë periudhë pati rritje me 100-128%. Megjithatë proporcioni i thirrjeve off-net ndaj totalit të thirrjeve drejt celularëve (on-net+off-net) për dy operatorët e mëdhenj vazhdon të jetë në nivele të ulëta 5-7%, krahasuar me nivele shumë të larta 93-95% të thirrjeve on-net.
 - 8.3. Operatorët përveç planeve tarifore standarde me kontratë aplikojnë programe tarifore të specifikuara/personalizuara për klientë/përdorues të veçantë, dhe këta përbëjnë një proporcion të rëndësishëm në numrin total të përdoruesve me kontratë.
- 9.** Vodafone dhe AMC me një shkresë të përbashkët (Nr.2743 Prot., datë 22.12.2014) drejtuar institucioneve kryesore të Shqipërisë, kanë shprehur shqetësime në lidhje me masat rregulatore të vendosuar më 6.11.2014, duke kërkuar rishikimin e asimetrisë së tarifës së terminimit në rrjetin Plus si dhe shtyrjen e afatit të aplikimit të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net deri më 1.07.2014.
- 10.** Plus me një shkresë (Nr.34 Prot., datë 16.01.2015) drejtuar institucioneve kryesore kërkon zbatimin e menjëhershëm të masave rregulatore të vendosura më 6.11.2014.
- 11.** Albtelecom me një shkresë (Nr.142 Prot., datë 21.01.2015) drejtuar institucioneve kryesore kërkon zbatimin e detyrimit të masave rregulatore të vendosura më 6.11.2014 dhe rishikimin e tarifës së terminimit në rrjetin Plus.
- 12.** AKEP bazuar në pretendimet e mësipërme të katër operatorëve celularë dhe informacionin shtesë të marrë prej tyre, vlerëson se:

- 12.1. Kundërshtimet e operatorëve mund të përmblihen/grupohen si më poshtë:
- 12.1.1. Një pjesë e konsiderueshme e pretendimeve të dërguara nga operatorët bazohen në argumentat e dërguara në procesin e këshillimit publik të dokumentit të analizës së tregut, të cilat janë trajtuar nga AKEP në Aneksin nr.2 të dokumentit përfundimtar të analizës, i cili përmban komentet e operatorëve dhe qëndrimin e AKEP për komentet.
 - 12.1.2. Vodafone, AMC dhe Albtelecom (EM) kundërshtojnë nivelin e tarifës së terminimit në rrjetin Plus, përfshirë nivelin e asimetrisë dhe mungesën e një glide-path (reduktimi të përshkallëzuar) për barazimin e tarifës së terminimit të Plus me tarifën e terminimit të operatorëve të tjerë, sidomos në kushtet e detyrimit për mos-diskriminim në tarifën on-net/off-net;
 - 12.1.3. Vodafone dhe AMC kundërshtojnë detyrimet e vendosura për mos-diskriminim në tarifën me pakicë on-net/off-net, duke kërkuar heqjen e tyre, ose shtyrjen e aplikimit minimumi duke filluar nga 1.07.2015;
 - 12.1.4. Plus kundërshton detyrimet e vendosura për mos-diskriminim në tarifën me pakicë on-net/off-net për Plus, duke kërkuar heqjen e këtij detyrimi për Plus, por zbatimin e tij për tre operatorët e tjerë;
 - 12.1.5. Plus kërkon që AKEP të ndryshojë përfundimin për tregun me pakicë celular, për t'a konsideruar atë si treg të justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante dhe të shpallë Vodafone, AMC dhe Albtelecom si operator me FNT në këtë treg dhe të vendosë detyrime në nivel me pakicë për këta tre operatorë;
 - 12.1.6. Vodafone, AMC dhe Albtelecom (EM) kundërshtojnë vendosjen e detyrimit të ndarjes së llogarive (Account Separation-AS) në kohën që tarifa e terminimit në rrjetet e tyre është reduktuar në nivelin 1.48 lek/minutë, që është sa niveli i tarifës mesatare në vendet që kanë aplikuar LRIC të pastër
- 12.2. Në lidhje me pretendimet e Vodafone (pika 3.1 dhe pika 3.3) që vendimet e AKEP kanë shkelur parimet e proporcionalitetit, sigurisë juridike etj, si dhe që nuk janë në përputhje me parashikimet e ligjit 9918, AKEP ka dhënë argumentimin në dokumentin e Analizës së tregut si dhe qëndrimet për komentet gjatë konsultimit publik. Njëkohësisht nëpërmjet rishikimit të afatit të fillimit të zbatimit të detyrimit për mos-diskriminim në tarifën on-net/off-net, si dhe ndryshime të tjera të kryera nga AKEP në vendimet e datës 6.11.2014 gjykon se operatorët do kenë kohën e nevojshme për kryerjen e ndryshimeve të kërkuara.
- 12.3. Kundërshtimet e AMC të paraqitura në pikën 4.3/a më sipër për metodën benchmark për tarifën e terminimit në nivelin mesatar të vendeve të BE që kanë aplikuar LRIC të pastër, si dhe kundërshtimet e Vodafone dhe AMC për reduktimin e shpejtë të tarifës së terminimit në nivelin 1.48 lek/minutë që pretendohet se ndikon negativisht në investimet e operatorëve dhe mund të çojë në rritje të tarifave të përdoruesve fundore janë me argumentim të njëjtë me komentet në procesin e këshillimit publik të analizës së tregut celular si dhe konsultimit publik të MTR-ve (Janar 2014), dhe AKEP ka mbajtur qëndrimin përkatës për këto argumenta/kundërshtime, qëndrim i cili është reflektuar në Dokumentin Final të analizës të telefonisë së

lëvizshme, (aneks 2) miratuar me VKD nr.2522, datë 06.11.2014, si dhe në qëndrimet për komentet në këshillimin publik për rishikimin e MTR, miratuar më 13.03.2014. Këto qëndrime të AKEP janë të publikuara edhe në faqen e Internetit të AKEP, si pjesë e dokumentave përkatës të miratuar nga AKEP.

12.4. Pretendimet e Plus në pikën 6.1 për problematikën e tarifave të ulëta on-net dhe masat rregulluese janë trajtuar nga AKEP në analizën e tregut celular, dhe në vijim të problematikës së evidentuar AKEP ka vendosur masat rregulluese për tregun përkatës të terminimit të thirrjeve, të cilat përfshijnë dhe detyrimin e mos-diskriminimit në tarifatat e thirrjeve on-net dhe off-net. Njëkohësisht në masat rregulluese të vendosura në analizën e tregut AKEP:

- ka reduktuar ndjeshëm tarifën e terminimit në rrjetet Vodafone, AMC dhe EM, duke përsheptuar dhe barazimin me vlerën 1.48 lek/minutë, e cila me vendimet e AKEP me 13.03.2014 ishte parashikuar të arrihej më 1.01.2016 njëkohësisht për të katër operatorët celularë;
- ka bërë diferencim të Plus në lidhje me tarifën e terminimit në rrjetin Plus, duke vendosur për një asimetri që në Dhjetor 2014 arriti në 340%.

Siç është theksuar edhe në dokumentin përfundimtar të analizës së tregut, Autoriteti i Konkurrencës (AK) në komentet e dërguara ka shprehur dakortësinë me analizën e tregut celular dhe masat rregulluese të vendosura nga AKEP, të cilat përmbushin rekomandimet e AK në vendimin nr.303, datë 16.01.2014.

Gjithashtu AKEP në trajtimin e problematikës së thirrjeve on-net/off-net ka marrë në konsideratë praktikën në vende të tjera, përfshirë dokumentin e cituar nga Plus, të cilat janë pjesë e dokumentit të analizës së tregut celular. Detyrimi i vendosur nga AKEP për mos-diskriminim në tarifatat e thirrjeve on-net/off-net është një masë rregullatore shtesë e vendosur nga AKEP për të adresuar pikërisht problematikën e evidentuar në tarifatat e thirrjeve on-net/off-net.

12.5. Pretendimet e Plus në pikat 6.2 dhe 6.4 për deformimet në konkurrencën në tregun me pakicë celular, plotësimin e testit të 3 kriterëve të tregut me pakicë celular si treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante, bazohen në argumentat e dërguara në këshillimin publik, për të cilat AKEP ka mbajtur qëndrimin përkatës për këto argumenta/kundërshtime, qëndrim i cili është reflektuar në Dokumentin Final të analizës të telefonisë së lëvizshme, (aneks 2) miratuar me VKD nr.2522, datë 06.11.2014.

12.6. Pretendimet e Plus në pikën 6.3 që detyrimet për mos-diskriminim në tarifatat on-net/off-net duhet të vendosen vetëm për operatorët e mëdhenj, nuk qëndrojnë pasi këto detyrime janë vendosur nga AKEP për të katër operatorët celularë për shkak se problematika shfaqet tek të katër operatorët celularë (evidentuar në dokumentin e Analizës së tregut). Argumentat e Plus bien në kundërshtim me pretendimet e mëparshme për këtë çështje, ku Plus është shprehur se aplikimi i politikave tarifore të ngjashme me operatorët e tjerë (tarifa shumë të ulëta on-net) ka qenë i detyruar për Plus për shkak të pozitës në treg të Plus (si hyrës i ri).

12.7. Pretendimet e operatorëve Vodafone dhe AMC për heqjen e detyrimit të mos-diskriminimit në tarifa on-net/off-net (pasi do të rezultojë në tarifa më të larta) nuk është i bazuar në argumenta shtesë mbi ato të dhëna gjatë kështillimit publik, dhe AKEP ka argumentuar detyrimin e vendosur në dokumentin e analizës së tregut celular. Masat rregulluese për aplikimin e detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net nga operatorët celularë synojnë ndryshime në strukturën tarifore të operatorëve celularë, dhe rritje të konkurrencës në programe standarde tarifore dhe uljen e tarifave të këtyre programeve dhe në tërësi rritjen e përfitimeve të përdoruesve fundorë. Pretendimet që mund të ketë rritje të tarifave të përdoruesve fundorë nuk janë të bazuara/kërcënim i besueshëm, pasi:

- Rritja e mundshme e tarifave on-net të paketave/opsioneve të caktuara nga nivele shumë të ulëta nën-kosto deri në 0 lek/minutë (apo reduktimi/eliminimi i tyre), pritet të shoqërohet me reduktime të ndjeshme të tarifave off-net dhe në total rritje të përfitimeve të përdoruesve fundorë
- Nëse një apo dy operatorë me pjesë të mëdha tregu tentojnë të mbajnë tarifa standarde në nivele të larta apo të rrisin ato, operatorët e tjerë më të vegjël mund të përfitojnë pjesë tregu nëpërmjet tarifave më të ulëta.
- Nëse kjo nuk ndodh (një apo dy operatorë të mëdhenj të ruajnë pjesë tregu të mëdha duke aplikuar tarifa shumë më të larta se operatorët e tjerë), atëherë AKEP do të duhet të rishikojë përfundimet e analizës së tregut celular pasi këto do të ishin shenja të dominancës (FNT) në tregun me pakicë, dhe/ose duhet të investigohen nga AK për abuzime të mundshme në tregun me pakicë.

12.8. Pretendimet e operatorëve Vodafone, AMC dhe Albtelecom për nivelin e asimetrisë së tarifës së terminimit në rrjetin Plus, i shoqëruar me detyrimin për mos-diskriminim në tarifatat me pakicë on-net/off-net, si dhe pretendimet/kërkesat e Vodafone dhe AMC për shtyrje të afatit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net të merren në konsideratë pjesërisht për arsyet e mëposhtme:

12.8.1. Niveli i asimetrisë së tarifës së terminimit në rrjetin Plus duke filluar nga 1.12.2014 (340% apo 5.04 lek/minutë) i shoqëruar me detyrimin për mos-diskriminim në tarifatat me pakicë on-net/off-net është shumë i lartë dhe duhet reduktuar;

12.8.2. Bazuar në konkluzionet e analizës së tregut dhe të dhënave më të fundit për trafikun e shkëmbyer midis operatorëve dhe trafikun on-net, gjykohet e arsyeshme që Plus të vazhdojë të ketë një nivel të arsyeshëm asimetrie (në vlerë absolute) edhe për një periudhë tranzitore të arsyeshme pas fillimit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net;

12.8.3. Aplikimi i detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net nga operatorët celularë do të sjellë ndryshime të rëndësishme në strukturën dhe nivelin e tarifave me pakicë celularë, të cilat kërkojnë kohën e majftueshme dhe resurset e nevojshme dhe të duhura nga operatorët celularë për t'u implementuar për rreth 3.3 milion përdorues aktivë apo

rreth 4.9 milion përdorues kartash SIM, dhe që përdorin programe/opsione të ndryshme tarifore, dhe përdorimi i planeve tarifore me kontrata standarde dhe me kontrata specifike për përdorues biznesi/ishtitucione rrit kompleksitetin e zbatimit të detyrimit për shkak të kushteve kontraktuale të operatorëve me këta përdorues. Për shkak të kompleksitetit më të madh të marrdhënieve të operatorëve me përdoruesit aktualë me kontratë, aplikimi i këtij detyrimi mund të kryhet i përshkallëzuar në dy faza: për përdoruesit me paragim dhe përdoruesit e rinj me kontratë dhe një fazë tjetër për përdoruesit aktualë me kontratë.

12.8.4. Sipas rekomandimeve të BEREC asimetria duhet të jete e përkohshme dhe e përcaktuar në kohe. AKEP në të gjitha vendimet e mëparshme për asimetrine ka përcaktuar dhe kohën e arritjes së konvergjencës (tarifave simetrike midis të gjithë operatorëve celularë).

12.8.5. Aplikimi i detyrimit të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net pritet të sjelle ndryshime në strukturën e trafikut dalës (rritje të proporcionit dhe vlerës absolute të trafikut off-net) dhe nivele shumë të larta të asimetrisë do të çojnë në pagesa neto të operatorëve të tjere shumë të larta (të pajustificuara) ndaj Plus.

12.9. Pretendimet e operatorëve Vodafone, AMC dhe Albtelecom për detyrimin e ndarjes së llogarive të merren në konsideratë pasi edhe në konkluzionet e Analizës së tregut të AKEP vihet re se ky detyrim nuk është i nevojshëm në kushtet që AKEP ka vendosur që tarifa e terminimit të këtyre tre operatorëve duke filluar nga 1.12.2014 të jetë në nivelin 1.48 lek/minutë, që përbën nivelin benchmark të tarifës së terminimit në vendet Evropiane që kanë aplikuar modelin e kostos “LRIC e pastër”, i rekomanduar nga Komisioni Evropian, si dhe e shoqëruar njëkohësisht me detyrimin e mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net. Siç është evidentuar edhe në dokumentin e analizës së tregut celular, përvoja në vendet e BE tregon që ato vende që kanë aplikuar tarifë terminimi sipas modelit të kostos “LRIC e pastër”, kanë hequr detyrimin e ndarjes së llogarive.

13. Për sa më sipër, AKEP gjykon që të bëjë ndryshime në Vendimet nr.2523-2526, datë 6.11.2014, si më poshtë:

13.1. Të përcaktojë një glide-path (reduktim të përshkallëzuar) në kohë të tarifës së terminimit të Plus sipas tabelës së mëposhtme:

Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (rishikim)

	1.04.2014	1.12.2014	1.04.2015	1.07.2015	1.01.2016
Vodafone/AMC	2.66	1.48	1.48	1.48	1.48
Albtelecom (EM)	4.00	1.48	1.48	1.48	1.48
Plus	6.52	6.52	4.00	2.66	1.48

Shenim: vlerat ne lek/minute pa TVSH

- Tarifat e mësipërme të Plus janë të njëjta me tarifat përcaktuara nga AKEP më 13.03.2014, duke përfshirë dhe një fazë reduktimi të ndërmjetëm nga niveli 4.00 në 2.66 lek/minutë në Korrik 2015;

13.2. Të përcaktojë si afat të fillimit të zbatimit të detyrimeve për mos-diskriminimin në tarifën on-net/off-net, afatet e mëposhtme:

- **data 1.07.2015:** për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj datë;
- **data 1.01.2016:** për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike).

13.3. Afatet e mësipërme nëkuptojnë që:

- duke filluar nga data 1.07.2015 nuk lejohet aplikimi i tarifave të ndryshme on-net/off-net për përdoruesit me parapagim, përdoruesit e rinj me kontratë dhe përdoruesit aktualë me kontratë që kryejnë rinovim të kontratës pas datës 1.07.2015;
- duke filluar nga data 1.01.2016 nuk lejohet aplikimi i tarifave të ndryshme on-net/off-net edhe për përdoruesit me kontrata specifike si dhe përdoruesit aktualë me kontratë;
- dy afatet e mësipërme janë të lidhura me datat e reduktimit të tarifës së terminimit në rrjetin Plus.
- secili operator celular ka kohën e mjaftueshme për të kryer ndryshimet e nevojshme dhe njoftuar përdoruesit për ndryshimet në tarifa, përfshirë përdoruesit me kontratë.

14. AKEP do të monitorojë nga afër zhvillimet në tregun celular, tarifën me pakicë si dhe efektet në trafikun on-net/off-net dhe pagesat neto midis operatorëve, dhe konkurrencën në tregun me pakicë celularë, për të gjykuar mbi nevojën e rishikimit të masave të mësipërme.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S:

1. Masat rregulluese (detyrimet) për sipërmarrësit me FNT të përcaktuara në dokumentin e analizës së tregut të miratuar me Vendimin nr. 2522, datë 6.11.2014, dhe me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr.2523-2526, datë 6.11.2014, të ndryshohen sipas përcaktimeve të pikave 2-6 të këtij Vendimi.
2. Në Vendimin nr.2522, datë 6.11.2014, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:
 - a. Në Kreun VI “Masat Rregulluese”, vlerat e tarifave të terminimit në rrjetin Plus Communication, të përcaktuara në Tabelën VI.4.2:

Rishikim i tarifave të terminimit celular në Shqipëri 2014- (versioni final), zëvendësohet me vlerat dhe afatet kohore sipas tabelës në vijim:

	1.04.2014	1.12.2014	1.04.2015	1.07.2015	1.01.2016
Vodafone/AMC	2.66	1.48	1.48	1.48	1.48
Albtelecom (EM)	4.00	1.48	1.48	1.48	1.48
Plus	6.52	6.52	4.00	2.66	1.48

Shenim: Vlerat ne lek/minute pa TVSH

- b. Kudo në përmbajtjen e dokumentit Analizë e tregut celular, ku shfaqen vlerat maksimale të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetin celular “Plus Communication” për periudhën nga 1.04.2015 e në vijim, do të jenë sipas vlerave të përcaktuara më sipër.
 - c. Paragrafi i fundit i Kreut VI.1 i emertuar “ Detyrimi per ndarjen e llogarive” si dhe kudo në përmbajtjen e Dokumentit të Analizës ku shfaqet detyrimi për ndarjen e llogarive, shfuqizohet.
 - d. Kudo në përmbajtjen e Dokumentit të Analizës ku përmendet afati për fillimin e aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare, data 1.01.2015 zëvendësohet me përcaktimet e mëposhtme:
Afati i zbatimit të detyrimit të të mos-diskriminimit në tarifatat brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare është:
 - i. data 1.07.2015 për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj date;
 - ii. data 1.01.2016 për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike
3. Në Vendimin nr.2523, datë 6.11.2014, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania”, kryhen ndryshimet e mëposhtme:
- a. Detyrimi i përcaktuar në pikat 2.3, 3.4/iii), për ndarjen e llogarive sipas nenit 41 të Ligjit 9918, shfuqizohet;
 - b. Pika 4.3 ndryshohet si më poshtë:
Afati i zbatimit të detyrimeve të pikave 4.1 dhe 4.2 është:
 - data 1.07.2015 për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj date;
 - data 1.01.2016 për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike).

4. Në Vendimin nr.2524, datë 6.11.2014, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Plus Communication sh.a. me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Plus Communication”, kryhen ndryshimet e mëposhtëme:

a. Tabela 1 në pikën 3.4 të ndrshon si më poshtë:

TABELA 1: VLERAT MAKSIMALE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETIN CELULAR PLUS COMMUNICATION

	1.04.2014	1.12.2014	1.04.2015	1.07.2015	1.01.2016
Tarifa e terminimit të thirrjeve	6.52	6.52	4.00	2.66	1.48

Shënim: Vlerat në lek/minutë pa TVSH

b. Pika 4.3 ndryshohet si më poshtë:

Afati i zbatimit të detyrimeve të pikave 4.1 dhe 4.2 është:

- *data 1.07.2015 për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj date;*
- *data 1.01.2016 për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specfike).*

5. Në Vendimin nr.2525, datë 6.11.2014, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a. me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albanian Mobile Communications”, kryhen ndryshimet e mëposhtëme:

a. Detyrimi i përcaktuar në pikat 2.3, 3.4/iii), për ndarjen e llogarive sipas nenit 41 të Ligjit 9918, shfuqizohet;

b. Pika 4.3 ndryshohet si më poshtë:

Afati i zbatimit të detyrimeve të pikave 4.1 dhe 4.2 është:

- *data 1.07.2015 për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj date;*
- *data 1.01.2016 për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike),.*

6. Në Vendimin nr.2526, datë 6.11.2014, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom”, kryhen ndryshimet e mëposhtëme:

- a. Detyrimi i përcaktuar në pikat 2.3, 3.4/iii) për ndarjen e llogarive sipas nenit 41 të Ligjit 9918, shfuqizohet;
- b. Pika 4.3 ndryshohet si më poshtë:
Afati i zbatimit të detyrimeve të pikave 4.1 dhe 4.2 është:
 - data 1.07.2015 për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj date;
 - data 1.01.2016 për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specfike).
7. Te gjitha pikat e tjera te Vendimeve nr. 2523-2526, datë 6.11.2014, mbeten të pandryshuara.
8. Të njoftohen sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., Plus Communication sh.a., Albanian Mobile Communications sh.a., dhe Altelecom sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
9. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Anila DENAJ**
- 3. Ketrin TOPÇIU**
- 4. Klarina ALLUSHI**